



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Blv "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 04228485

E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr 1347 prot

Tiranë, dt 30/12/2016

UDHËZIM

Nr 2 Datë 30/12/16

“MBI RITJEN E KAPACITETEVE AUDITUESE DHE E CILËSISË SË AUDITIMIT”

KLSH është institucioni më i lartë i auditimit në vend dhe luan rol parësor në promovimin e mirë qeverisjes dhe në shtimin e vlerës së parasë publike. Për këtë Shoqëria dhe Parlamenti pret nga institucioni ynë, jo vetëm auditime cilësore, por edhe nivelet më të larta të transparencës, të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies. Kuvendi i Shqipërisë, përmes Rezolutës së Tetorit 2016, shprehu këto aspirata dhe pritshmëri, mbi bazën e të cilave u zhvilluan plan veprimet institucionale, të cilat përfshinë si komponent thelbësor, zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe rritjen e cilësisë së auditimit.

INTOSAI, përmes Deklaratës në Kongresit të XXII të Abu Dhabit, shprehet gjithashtu për këtë nivel të lartë pritshmërie ndaj audituesve shtetëror. Ajo cilëson se është detyrë e Institucioneve Supreme të Auditimit të performojnë auditime cilësore dhe të mbështesin aspiratat për mirëqeverisje. Deklarata e Abu Dhabit cilëson implementimin rigoroz të standardeve të auditimit, forcimin e integritetit dhe etikës dhe trajnimin e vazhdueshëm profesional. Në nivel global, INTOSAI ka identifikuar gjithashtu nevojën për të forcuar përpjekjet e përbashkëta drejt kompetencave, aftësive profesionale, etikës, vlerave dhe sjelljes për të mbështetur dhe rritur kapacitetet audituese dhe cilësinë e auditimit.

Në të njëjtën linjë janë edhe rekomandimet e Progres Raportit në Bashkimit Evropian për vitin 2016, për vendin tonë. Ky Progres Raport ka evidentuar dhe vlerësuar zhvillimin metodologjik të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke shprehur se rëndësi parësore ka aplikimi në praktikë i kësaj metodologjie.

Ky udhëzim është pjesë e Strategjisë së Zhvillimit, 2013-2017, e rishikuar, e cila është në koherencë të plotë me Strategjinë për Zhvillim të INTOSAI-t, në kuadër të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm Profesional. Në filozofinë tonë zhvillimi i kapaciteteve audituese dhe të cilësisë në auditim realizohet përmes përmirësimit të aftësive, njohurive, strukturave dhe mënyrës së të punuarit për të arritur standardet më të larta të profesionalizimit, transparencës dhe përgjegjshmërisë. Ai është pjesë e zinxhirit të hapave të ndërmarra në drejtim të zhvillimit institucional, por edhe individual të audituesit në KLSH. Në këtë aspekt më shumë se sa një Udhëzim që synon të promovojë zhvillimin, ai është një normë që tregon për përgjegjshmërinë tonë ndaj qytetarit dhe shoqërisë. Ky Udhëzim synon nxitjen e qëndrimeve dhe të një stili jetese, ku kërkesa e llogarisë për vete dhe për kolegun, nxit frymën e bashkëpunimit dhe të përgjegjshmërisë. Përpjekjet e institucionale të KLSH-së për të aplikuar standardet e auditimit dhe praktikatat e mira audituese duhet të mbështeten me këtë stil individual qëndrimi. Për të udhëhequr këto përpjekje në drejtim të fizionomisë së institucionit dhe të punës audituese vjen ky Udhëzim si një përjasje normative dhe promotor i zhvillimit personal.

Baza për zhvillimin e këtij udhëzimi

Ky udhëzim është një përmirësim i Udhëzimit Nr 3, "Mbi zhvillimin e vazhdueshëm profesional", të vitit 2012.

Ai është në zbatim të kërkesave të Ligjit 154/2014 "Për Funkcionimin dhe Organizimin e Kontrollit të Lartë të shtetit", në zbatim të plan veprimit të Strategjisë për Zhvillim të KLSH-së, 2013 – 2017, të kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe të kërkesave të Deklaratës së Kongresit XXII të INTOSAI-it, në Abu Dhabi.

Ai është projektion i praktikave më të mira dhe standardeve të auditimit ISSAI 10 – 40 "Kërkesat Bazë për funksionimin e Institucioneve Supreme të Auditimit", niveli i Tretë "Mbi Kërkesat themelore për ushtrimin e funksionit të audituesit"; projektion i vizionit tonë për zhvillim institucional dhe i misionit tonë kushtetues.

Metodologjia e përdorur

Ky Udhëzim mbështet në metodologjinë e shprehur në dokumentin e INTOSAI "Zhvillimi Profesional" – 2014; në dokumentin e SIGMA-s, "Arritja e një cilësie të lartë të punës në Institucionet Supreme të Auditimit"- 2014; në dokumentin e IDI, "Vlerësimi i Kapaciteteve Zhvillimore, një Udhërrëfyes për Institucionet Supreme të Auditimit" – 2009. Zhvillimi i kapaciteteve të auditimit dhe i cilësisë së auditimit është pjesë e një zinxhiri hapash, të cilat synojnë shtimin e vlerave në të gjithë dimensionet e profesionit të audituesit. Ai është pjesë e ndërmarrjes institucionale të materializuar së pari në një qasje të evidentimit të profesionit të audituesit, duke evidentuar në vijim strategjinë zhvillimore institucionale, si dhe duke shprehur dinamikën e ndryshimeve në ambientin e jashtëm dhe të brendshëm të institucionit. Për këtë ky udhëzim është organizuar duke trajtuar shkurtimisht këto tre hapa, me qëllim evidentimin sa më të qartë të dimensionit të zhvillimit që synohet të promovohet.

1. Kërkesat e profesionit të audituesit

Identifikimi i kapaciteteve audituese paraqet rëndësi në orientimin e përpjekjeve për zhvillim. Një referencë të mirë për të identifikuar dimensionet profesionale janë standardet e auditimit dhe përcaktimet që INTOSAI jep për profesionin e auditimit. ISSAI 12 përshkruan tre parimet me të cilat Institucionet Supreme të Auditimit duhet të gjenerojnë vlerën dhe përfitimet që priten nga ato, për të bërë një ndryshim në jetën e qytetarëve. Ato janë:

- kontributi në rritjen e llogaridhënies, integritetit dhe transparencës së subjekteve qeveritare dhe publike
- demonstrimi i rëndësisë së vazhdueshme ndaj qytetarëve dhe aktorëve të tjerë
- përpjekjet intensive për të qenë model integriteti dhe profesionalizmi

Në KLSH standardet e auditimit shihen si norma për ndjekje, duke na orientuar në drejtim të pavarësisë dhe nivelit të angazhimit ndaj praktikave më të mira. Ato tregojnë për kërkesat që duhet të përmbushen, për të qenë një kontribues i rëndësishëm për jetën e qytetarëve.

Në funksion të përcaktimit të rrugëve të zhvillimit të profesional të audituesit shtetëror, nga INTOSAI janë përcaktuar katër elementë që karakterizojnë profesionin e audituesit. Ato janë:

- kuadri i standardeve profesionale, të cilat udhëheqin kryerjen e profesionit
- kuadri i standardeve profesionale, të cilat shërbejnë si bazë për të zhvilluar kompetencat e nevojshme profesionale për të kryer punën audituese
- kërkesa/rregullime specifike për mjedisin e realizimit të punës audituese
- procedura rregullatore dhe qeverisëse specifike, të cilat kanë të bëjnë me korniza të tjera të vlerësimit

13

Elementi i parë i referohet kuadrit profesional, standardeve apo kërkesave që duhen për profesionin e audituesit. Në këndvështrimin e INTOSAI, kuadri i standardeve ISSAI është kuadri në të cilën duhet të mbështet profesioni i audituesit të sektorit publik.

Elementi i dytë ka të bëjë me kompetencat profesionit që audituesi duhet të kenë për të zbatuar mandatin e tyre sipas praktikave më të mira e të reflektuara përmes standardeve. Në këtë kontekst, përkufizimi i INTOSAI-t për profesionin e audituesit, i referohet një sërë kompetencave zakonisht të përbashkëta dhe thelbësore për një auditues në sektorin publik (ISSAI 100).

Elementi i tretë kërkon që të përcaktohen masa apo kërkesa të veçanta në ambientin e punës. Ato janë aktualisht të përcaktuara në nivelin 2 të kornizës ISSAI (10-99), ku janë artikuluar kërkesat për transparencë, përgjegjshmëri e ku përfshihet dhe Kodi i Etikës.

Elementi i katërt shpreh një mekanizëm rregullator që kontrollon përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në standardet. Për të mbështetur dhe për të vlerësuar zhvillimin profesional të një Institucioni Suprem Auditimi, praktikat më të mira aplikojnë një kornizë vlerësimi, të tillë si Indikatorët e Performancës dhe të Përputhshmërisë, përveç praktikave të tjera të vlerësimit.

Mbështetur në përshkrimin e karakteristikave të profesionit nga INTOSAI dhe specifikisht në përputhje me elementin e dytë, zhvillimi kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit shihet si një përpjekje për përmirësuar aftësitë profesionale dhe personale të audituesit. Në ndërgjegjësim të plotë se një profesionit më i mirë është ai që zhvillohet edhe në dimensionet personale, ky Udhëzim del jashtë kërkesave strikte të zhvillimit profesional, duke synuar edhe zhvillimin individual.

Vlerësimi i kapaciteteve audituese paraqet gjithashtu një rëndësi parësore në ofrimin e një informacionit se ku dhe si duhet të orientohen përpjekjet për zhvillim. Në KLSH janë aplikuar disa metoda në këtë drejtim. Vlerësimi tradicional epror-vartës është zhvilluar më tej, në bazë të praktikave më të mira, në procese të vetë vlerësimit dhe të rishikimit mes kolegësh. Aktivitete si workshope dhe sesione peer review janë zhvilluar në këtë drejtim, duke mbështetur proceset me kohë dhe energji. Një konsideratë e lartë e është dhënë informacionit që vjen nga Shoqëria, duke promovuar rëndësinë që ky informacion ka për vlerësimin tonë.

Në funksion të përmbushjes së objektivave strategjike, por edhe të përthithjes së informacionit për të zhvilluar figurën e audituesit të jashtëm publik, janë zhvilluar marrëdhëniet me shoqërinë civile dhe botën akademike. Pjesmarrja e tyre në aktivitetet institucionale është shprehje e dëshirës për një rritje cilësore dhe me baza shkencore profesionale.

Kuvendi i Shqipërisë shfaqet gjithashtu si një indikator i zhvillimit. Ai, përmes Rezolutës së Tetorit 2016 kërkon që të jemi elementi kyç në sistemin e menaxhimit financiar publik në Shqipëri. Për të realizuar këtë në nivelet më të larta të përgjegjshmërisë, transparencës dhe llogaridhënies, në objektivin e gjashtë të tij, kjo rezolutë parashtron që “*KLSH të vijojë me përmbushjen e objektivave për rritjen e kapaciteteve audituese të burimeve njerëzore dhe forcimit të kapaciteteve institucionale, duke përqsuar metodologji moderne për auditim, për t’iu përgjigjur nivelit të parametrave të kërkuar nga INTOSAI dhe rekomandimeve të dhëna nga kjo rezolutë*”.

Po në të njëjtin funksion KLSH ka intensifikuar marrëdhëniet me homologët ndërkombëtarë, duke i përfshirë ata në proceset zhvillimore institucionale, ku më i rëndësishmi është ai i IPA 2013. Ky projekt ka formën e binjakëzimit mes institucioneve, me objektiv forcimin e kapaciteteve në auditimit të jashtëm në Shqipëri. Përmes bashkë finacimit me Bashkimin Evropian, KLSH ka angazhuar ekspertët e SAI Polak dhe Kroat në një veprimtarinë e saj të zhvillimit të punës audituese dhe rritjes së cilësisë së auditimit. Trajnimi i audituesve në institucione homologe si ai i Turqisë, ECA dhe INTOSAI-it është tashmë një traditë e mirë

14

konsoliduar. Zhvillimi i konferencave shkencore me pjesmarrjen e homologëve ndërkombëtar është gjithashtu një qasje zhvillimore për të përfituar nga eksperiencia e përbashkët.

2. Strategjia për Zhvillim dhe proceset evolutive institucionale

Mendimi strategjik, në KLSH, ka përfshirë daljen nga kornizat e performuesit nacional, duke iu referuar normave ndërkombëtare të auditimit publik. Kjo përjasje që sfidon mendimin konvencional ka prekur në shumë dimensione institucionin. Formësimi dhe identifikimi i KLSH-së si një institucion prestigjioz auditimi, ka ardhur si pasojë e ndërgjegjësimit se veprimtaria e saj është e udhëhequr nga një Mision i qartë dhe kuptimplotë dhe nga një Vizion i saktë se ku jemi duke shkuar. Për këtë KLSH ka kristalizuar Strategjinë e Zhvillimit 2015-2017, në përputhje me Misionin dhe Vizionin e saj, të detajuar në një pemë zhvillimi. Secila prej objektivave të strategjisë është detajuar në degë ku detajohen planet individuale, përmes të ashtuquajturave nën objektiva, të cilat udhëheqin në mënyrë të detajuar veprimtarinë zhvillimore. Kjo natyrë e strategjisë shprehet në fokusin drejt:

1. Ngritjes së kapaciteteve;
2. Qasjes ndaj standardeve profesionale
3. Shkëmbimi i njohurive dhe përvojës; dhe
4. Menaxhimi në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe efektive të komunikimit

Pjesë e kësaj strategjie është nën objektivi 3.4 “Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore individuale”. Në funksion të këtij qëllimi është realizuar analizimi individual i nevojave për zhvillim, plan trajnimet e diferencuara në bazë të eksperiencës, tematikës dhe burimeve të informacionit.

Strategjia për Implementimin e Standardeve të Auditimit ISSAI është pjesë e Strategjisë për Zhvillim Institucional. Ajo është projektuar gjithashtu në frymën e promovimit të zhvillimit profesional të audituesit. Kjo frymë shprehet në atë që secila etapë e saj e zhvilluar është shoqëruar me procese trajnimi gjithë përfshirëse, pjesë e programeve vjetore trajnuese. Këto natyrë e strategjisë dhe plan veprimeve të detajuara të saj na ofrojnë një pamje të qartë se prej audituesit në KLSH pritet angazhimi në procese të zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe individual.

3. Dinamika e ndryshimeve dhe menaxhimi i tyre

Pas vitit 2012 në KLSH është realizuar një reformë gjithëpërfshirëse për zhvillimin institucional. Në funksion të kësaj reforme është përmirësuar në mënyrë thelbësore kuadri ligjor dhe organizativ me Ligjin nr. 154/2014 “Për Organizmin dhe Funksionimin e KLSH-së”. Ky ligj shpreh për herë të parë juridikisht detyrimin për zbatimin dhe ndërmarrjen e veprimtarisë audituese në përputhje me normat e Deklaratës së Limës dhe standardeve të auditimit ISSAI. Në zbatim të detyrimeve ligjore është realizuar një ndërmarrje e madhe zhvillimore në drejtim të burimeve njerëzore, duke krijuar një sërë politikash menaxhuese dhe promovuese. Kodi i Etikës, tashmë pjesë e rëndësishme e këtyre politikave përbën dokumentin më të rëndësishëm për të udhëhequr etikën profesionale audituese.

Krijimi i një kuadri rregullator me anë të përditësimit të Rregullores së Brendshme, Rregullores së Procedurave të Auditimit ka zhvilluar dimensionin e funksionimit transparent, të pavarur dhe profesional në audituesit dhe të raportit të tij me menaxhimin e lartë. Gjithashtu ligji i ri ka zgjeruar dimensionet e funksioneve audituese të institucionit në drejtim të tipeve të reja auditimit si ai i performancës, financiar dhe i IT, duke rritur sfidat e punës audituese. Ndryshimet dhe zhvillimet që kanë ndodhur në ambientin veprues të KLSH-së gjatë viteve të fundit, dimensionet e reja audituese të shprehura në Ligjin e Ri, nxorën në pah nevojën për rishikim dhe përshtatje të strukturës organizative dhe formave të

15

bashkëveprimet midis njësive të Institucionit. Për këtë institucioni u riorganizua në departamente më të specializuara dhe të fokusuara në këto dimensionet të reja të auditimit. Në funksion të zhvillimit profesional të audituesit janë realizuar trajnime në KLSH dhe jashtë saj. Tashmë që prej vitit 2012 është zhvilluar një traditë e konsoliduar trajnimi, me një mesatare prej 25 ditësh për auditues. Procesi i trajnimit përfshin njohuri nga burime të larmishme informacioni, duke angazhuar ekspertë jashtë KLSH-së, ekspertë të institucioneve homologe të auditimit dhe ekspertë të fushës akademike dhe profesionale. Për këtë është zhvilluar një fushatë e madhe kontaktesh dhe marrëveshjesh bashkëpunimi me shoqërinë civile, institucionet shkencore dhe profesionale.

Ndikimi i drejtpërdrejtë i zhvillimit institucional dhe rëndësia e madhe që i jepet cilësisë së veprimtarisë audituese, e ka shndërruar zhvillimin e profesional individual, në një domosdoshmëri për secilin nga punonjësit e institucionit. Ky ndryshim, tashmë evident në zhvillimin institucional, kërkon nga punonjësi të ndërmarrë në mënyrë të vazhdueshme hapa në drejtim të zhvillimit individual profesional, si e vetmja rrugë në menaxhimin e ndryshimit të madh që ka përjetuar institucioni.

Për sa trajtuar më lart dhe në funksion të rritjes së kapaciteteve audituese dhe të cilësisë së auditimit:

UDHËZOJ

1. Audituesit nxiten të marrin pjesë në aktivitete shkencore dhe profesionale të shoqatave të zhvillimit profesional dhe të instituteve të kërkimit universitar. Nxiten audituesit të anëtarësohen në këto organizime profesionale, shkencore dhe civile, duke qenë pjesë aktive e trajnimeve dhe e aktiviteteve të organizuara nga këto trupa profesionale.
2. Audituesit nxiten të marrin pjesë aktive në workshop-e, peer review dhe konferenca shkencore të zhvilluara nga KLSH në bashkëpunim me shoqatat e zhvillimit profesional dhe institutet e kërkimit universitar.
3. Audituesit nxiten të rrisin frymën e debatit me qëllim shkëmbimin e eksperiencës me ekspertët e jashtëm të angazhuar nga KLSH, diskutime të cilat do të mbështeten me infrastrukturë, ambiente dhe pajisje hardwëre.
4. Audituesit që kanë përfunduar studimet e larta në një degë universitare, të cilët punojnë pranë Departamenteve të Auditimit duhet të përsosin dhe plotësojnë formimin arsimor-profesional dhe konkretisht:
 - a. Audituesit, nën moshën 45 vjeç, nxiten të vazhdojnë më tej studimet në doktoraturë apo në certifikime profesionale të fushës si Kontabël i Miratuar, Ekspert Kontabël i Autorizuar, ACCA- Kontabël i Certifikuar Ndërkombëtar, CPA – Auditues i Certifikuar Publik etj.
 - b. Nxiten dhe do të mbështeten përpjekjet e audituesve, të cilët do të vazhdojnë një fakultet të dytë me kohë të pjesshme.
 - c. Audituesit me profil ekonomist, të aplikojnë për regjistrim në programin e trajnimit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pranë Njesisë Qendrore të Harmonizimit dhe Auditimit të Brendshëm.
 - d. Audituesit, në varësi të profilit të diplomimit nxiten të fitojnë tituj si Ekspertë në fusha të ndryshme, p.sh. në vlerësimin e pasurive të paluajtshme, të studimeve të fizibilitetit etj.
 - e. Me qëllim forcimin dhe përmirësimin e dijeve dhe të koncepteve të auditimit mbi teknologjinë e informacionit, audituesit nxiten të trajnohen dhe të certifikohen në software të përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave, si dhe në programe vizualizimi si RAË, Dygraphs, Visual, etj.

- f. Në funksion të rritjes së cilësisë së auditimeve financiare audituesit nxiten të përmirësojnë dijet e tyre dhe të certifikohen në programet e regjistrimit kontabël të të dhënave si Alfa, Financa, Biznes etj
 - g. Audituesit nxiten për të marrë pjesë në trajnimet *on line* të zhvilluara nga IDI Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI, CEF – Qendra për Ekselencë në Financë, CIPFA- Instituti për Diplomim në Financat Publike dhe Kontabilitetit, etj
5. Audituesit nxiten të zhvillojnë njohuritë dhe të dëshmojnë certifikimin e gjuhëve të huaja në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, në Universitetin e Tiranës, si dhe mbrojtjen e testeve alternative si TOEFL, IELTS etj.

Për të gjithë audituesit që do të respektojnë rekomandimet e sipërcituara, por edhe përpjekje të tjera në këtë drejtim, nga KLSH do t’ju krijohen kushte lehtësuese. Respektimi i objektivave që parashtron ky Udhëzim përbën kusht favorizues për karrierën e audituesve.

Me ndjekjen e këtij Udhëzimi ngarkohen respektivisht Drejtorët e Departamenteve të Auditimit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Zhvillimit dhe e Metodologjisë.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Bujar LESKAJ

KRYETAR



Punoni: Edvin Stefani

Miratoi: Luljeta Nano